



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 208/7 prot.

Tiranë, më 12.5.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 634, datë 10.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Naim Tota
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 28.4.2023, është njoftuar vendimi nr. 634, datë 10.3.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Naim Tota, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 2.5.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, datë 2.5.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 634, datë 10.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Naim Tota, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Naim Tota, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (*në vijim referuar si KLP*), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Naim Tota*”² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.11.2017, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Naim Tota*”, raport i deklasifikuar plotësisht, pas kërkesës së Komisionit për përditësim dhe deklasifikim informacioni.

2.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Naim Tota.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur⁴, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet, pagimin e detyrimeve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të dalë nga hetimi administrativ lidhur me këtë kriter, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, në përfundim të vlerësimit tërësor të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI me nr. ***/** prot., datë **.10.2018.

³ Raport i KLP nr. *** prot., datë **.11.2022.

⁴ Për më tepër referohuni në f. 46, 47 dhe 49 të vendimit.

çështjes, ka vlerësuar se: [...] *Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve të rezultuara për disa vite nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se pasaktësitë e konstatuara dhe balancat negative të fondeve për disa vite të caktuara nuk kanë ndikuar në mënyrë thelbësore në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare, nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Naim Tota ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit Dh të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në konsideratë të verifikimit dhe konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit Naim Tota ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar raportin e përgatitur nga KLP-ja, denoncimet e publikut dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se: [...] *në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016 [...].*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash⁵, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Naim Tota, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

⁵ Anëtar i trupit, z. ***,*** ka dalë me mendim në pakicë për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁶ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁷ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 2.5.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. 208/3 prot., aktin “*Rekomandim për paraqitje ankimi*” ndaj vendimit nr. 634, datë 10.3.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Naim Tota (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Objekti i këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ për kriterin e pasurisë dhe atë profesional, pasi në vlerësimin e ONM-së, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të përmbysë barrën e provës. Për këtë arsye, rekomandohet që procesi i rivlerësimit për z. Tota të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Për kriterin e pasurisë, ONM-ja vlerëson se informacioni dhe dokumentacioni i mbledhur përgjatë hetimit administrativ demonstron kushtet e fshehjes së pasurisë *apartment*, ndodhur në Rr. “****”, nga ana e subjektit të rivlerësimit. Sikurse arsyetohet më tej në këtë rekomandim, një analizë financiare e fokusuar në personin tjetër të lidhur, znj. ***.***, tregon mungesë të burimeve të ligjshme për të siguruar huan në shumën 400.000 lekë, dhënë bashkëshortes së ndjerë të subjektit të rivlerësimit, me qëllim blerjen prej saj të aksioneve të kompanisë “****” sh.a., në vitin 2005. Gjithashtu, shihet e nevojshme kryerja e një analize financiare gjithëpërfshirëse dhe të saktë nga ana e Kolegjit, me qëllim vlerësimin nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurisë dhe pagimin e shpenzimeve gjatë viteve, parë kjo në këndvështrimin e pasaktësive të konstatuara në deklaratat periodike dhe atë “Vetting” të subjektit të rivlerësimit. Në përfundim, ONM-ja vlerëson se në procesin e rivlerësimit të përfshihen edhe gjetjet lidhur me kriterin e aftësive profesionale, rezultuar edhe nga denoncimet e ardhura nga publiku.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat e njohura, Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

⁶ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁷ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 634, datë 10.3.2023, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të pasurisë dhe vlerësimin e aftësive profesionale, duke bërë kështu pjesë të shkaqeve të këtij ankimi, për sa parashtrohet edhe në aktin rekomandim, paraqitur nga ONM-ja.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 634, datë 10.3.2023, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A Kontrolli i pasurisë

12. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

13. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Naim Tota, ushtron detyrën e prokurorit prej vitit 1996, duke dorëzuar deklaratën e interesave privatë për herë të parë në vitin 2004, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, në vijim ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave privatë periodikë për vitet 2004 - 2016 dhe, në datën *.1.2017, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën "Vetting", sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave

si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, janë:

15. Apartament banimi 2+1, i ndodhur në rrugën “** ****”, Tiranë, përfituar me kontratën e cedimit të datës **.3.2016, me vlerë 50.000 USD**

15.1 Në *D-Vetting*, subjekti deklaron: Apartament 2+1, në rrugën “**** ****”, Tiranë, blerë me kontratën e cedimit nr. *** rep. dhe *** kol., datë **.3.2016, “Për kontratën e cedimit të drejtave të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., datë **.4.2003”, për vlerën (çmimi) prej 50.000 USD⁸. Kjo vlerë është paguar nga ana ime me të ardhurat prej 5.000.000 lekë, të realizuara nga shitja e apartamentit në Kukës, si dhe me të ardhurat dhe kursimet e mia në vite. *Pjesa takues: 100%.*

15.2 Në *DV-2016*, subjekti deklaron si më sipër pasurinë e llojit “*apartament banimi 2+1*”, të ndodhur në rrugën “**** ****”, Tiranë.

15.3 Në deklaratimet periodike të viteve 2004 – 2016, subjekti ka deklaruar si adresë ku është regjistruar në gjendjen civile dhe adresë banimi: rruga “**** ****”, Tiranë (pallati “****”). Gjatë kësaj periudhe, rezulton se vetëm në *DV-2008*, subjekti kur ka deklaruar adresën si më sipër, ka vënë dhe shënimin (*me qira*).

15.4 Në *DV-2017*, në seksionin: “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*”, subjekti ka deklaruar: “*Hipotekuar me certifikatën për vërtetim pronësie nr. **, apartamenti 2+1 (sipërfaqe totale 96,21 m²), më datë **.8.2017, në rrugën “**** ****”, Tiranë, blerë me kontratën e cedimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2016 (deklaruar më parë)*”.

15.5 ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Jug⁹, ka konfirmuar se në emër subjektit të rivlerësimit figuron e regjistruar pasuria me nr. **, vol. **, f. **, z. k. **, e llojit “apartament me sipërfaqe 86,21 m² dhe me sipërfaqe të përbashkët 10,58 m²”, ndodhur në rrugën “**** ****”, Tiranë.

15.6 Lidhur me të drejtat dhe origjinën e përfitimit të kësaj pasurie, nga vlerësimi i akteve në dosje, rezulton se me kontratën e sipërmarrjes të datës **.4.2003, konfirmuar nga noteri publik sipas vërtetimit të nënshkrimit me nr. *** rep., palët nënshkruese, z. ***.*** (bashkëshorti i motrës së subjektit/kunati), në cilësinë e porositësit dhe shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit kanë rënë dakord për ndërtimin dhe dorëzimin e pasurisë së llojit *apartament banimi (2+1)* me sipërfaqe 102,51 m², ndodhur në rrugën “**** ****”, Tiranë, përkundrejt vlerës prej 50.000 USD. Sipas kësaj kontrate, çmimi do të likuidohet në tri këste brenda vitit 2003¹⁰, ku: (i) kësti i parë në vlerën prej 25.000 USD, është likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës (datë **.4.2003); (ii) kësti i dytë në vlerën prej 10.000 USD, brenda datës **.6.2003; dhe (iii) kësti i tretë në vlerën prej 15.000 USD, brenda datës **.10.2003.

⁸ Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën 5.000.000 USD.

⁹ Shkresa nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me nr. ***/** prot., datë **.11.2020.

¹⁰ Sipas akteve në dosjen e ILDKPKI-së, aneks **, f. **, bashkëlidhur kontratës, gjenden dhe 3 mandatpagesa, pjesërisht të lexueshme, nga ku duket se z. ***.*** ka likuiduar plotësisht çmimin gjatë vitit 2003, përkatësisht (i) në datën **.4.2003, shumën prej 25.000 USD; (ii) në datën **.6.2003, shumën prej 10.000 USD; dhe (iii) në datën **.12.2003, shumën 15.000 USD.

Gjithashtu, në këtë kontratë është rënë dakord që apartamenti duhet t'i dorëzohet porositësit brenda muajit maj të vitit 2004.

15.7 Nga hetimi administrativ¹¹ ka rezultuar se kjo pasuri është përdorur krejtësisht nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij, duke gëzuar të drejtën e gëzimit dhe posedimit në mënyrë të pandërprerë, marrëdhënie kjo që herë rezulton të jetë deklaruar nga subjekti si marrëdhënie qiraje, referuar DV-2008, e herë si huapërdorje, referuar pyetësorit standard. Më tej, pas gati 12 vitesh përdorim të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, me kontratën e cedimit të të drejtave të datës **.3.2016, ka fituar të drejta pronësie, duke e regjistruar në titull të tij përfundimisht pronësinë e apartamentit në datën **.8.2017¹², në zbatim të vendimit gjyqësor me nr. ***, datë **.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë¹³.

15.8 Referuar përmbajtjes së kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., të datës **.3.2016, për cedimin e të drejtave të kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., datë **.4.2003, nënshkruar midis z. ***.***, në cilësinë e ceduesit dhe subjektit të rivlerësimit, z. Tota, në cilësinë e cesionarit, përfituesit, rezulton se palët kanë rënë dakord që ceduesi të kalojë të drejtat e fituara nga kontrata e sipërmarrjes së sipërcituar, lidhur me apartamentin e ndodhur në rr. “**** ****”, Tiranë, te cesionari, subjekti i rivlerësimit. Sipas kësaj kontrate, rubrika “Deklarime paraprake” ka rezultuar se si shkak ligjor i cedimit të të drejtave, ndër të tjera (pikat 4, 6 dhe 7), palët njohin dhe pranojnë këto fakte:

- (i) *Ceduesi deklaron se pagesat e këtyre tri kësteve në vlerë 50.000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi;*
- (ii) *Përfituesi, ka paguar për blerjen e të drejtave të apartamentit sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes;*
- (iii) *Duke pasur parasysh atë çka përmendet më lart, palët kanë rënë dakord të hyjnë në këtë kontratë për transferimin e të drejtave mbi apartamentin që lindin nga kontrata e sipërmarrjes dt. **.4.2003.*

15.9 ILDKPKI-ja, referuar procesverbalit të datës **.5.2016, ka pyetur (pyetja nr. **), subjektin e rivlerësimit lidhur me adresën e banimit dhe subjekti është përgjigjur se: “*Pas shitjes së shtëpisë në Kukës dhe transferimit tim në Tiranë, pra në vitin 2013 e në vazhdim kam jetuar në apartamentin rruga “**** ****”, pallati i firmës “****”, shk. **, e cila është në pronësi të kunatit ***.***, dhe unë kam jetuar në shtëpinë e tij... Nuk kam lidhur kontratë qiraje për faktin se unë i kam dhënë huan në vlerën 40.000 euro, në vitin 2008*”. Kjo përgjigje e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me atë çfarë ka deklaruar ai gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorit standard (pyetja nr. **), dhe provave të paraqitura prej tij në mbështetje të

¹¹ Për më tepër referohuni në rezultatet e hetimit administrativ, pyetësorin standard, pyetësorin nr. 2, si dhe dëshmisë së dhënë nga shtetasi ***.***, para Komisionit, si dhe procesverbalit të ILDKPKI-së të datës **.5.2016.

¹² Në datën **.4.2017, nga ZVRPP Tiranë, është lëshuar certifikata e pronësisë për pasurinë objekt vlerësimi, pasuria me nr. ***, vol. **, faqe ***, Z. K. ***, e llojit *apartament*, me sipërfaqe 96,21 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 10,58 m², në emër të shtetasit ***.***, me shënim në kartelën e pasurisë: “Leje legalizimi”, ndërsa në seksionin e hipotekave, vendimeve të Gjykatave, kufizime etj., të kësaj karteje është shënuar: “*kufizohen veprimet deri në realizimin e kontratës së shkëmbimit*”. Në vijim rezulton se, në datën **.7.2017, në të njëjtën seksion të kartelës së kësaj pasurie, është shënuar “*...Regjistrohet vendimi i gjykatës me nr. *** regj., nr. ***, datë **.01.2017, për njohje të pronësisë dhe njohje të efekteve të kontratës së sipërmarrjes me nr. *** rep., datë **.4.2003, shoqëria “****” sh.p.k., kundrejt z. Naim Tota...*”.

¹³ Objekti i konfliktit gjyqësor sipas këtij vendimi, me paditës subjektin e rivlerësimit dhe të paditur Shoqëria “****” sh.p.k., person të tretë ZVRPP Tiranë, ka qenë: “Detyrimi i palës së paditur të zbatojë efektet e kontratës së sipërmarrjes së datës **.4.2003 me nr. **** rep., duke njohur paditësin pronar mbi pasurinë e paluajtshme të llojit *apartament* që përbëhet... me adresë në rruga “**** ****”, Tiranë, bazuar në lejen e ndërtimit, të miratuar me vendimin nr. **, datë **.5.2001, të KRRT”.

deklarimeve. Referuar deklaratës noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2020, nënshkruar nga kunati i subjektit, shtetasi ***.***, dhe bashkëshortja e këtij të fundit, motra e subjektit, znj. ***.***, deklarohet se: “... kemi strehuar familjarisht nënën (nënen e ***.***,) dhe vëllain ***.*** bashkë me familjen e tij. Banesën tonë, ata e kanë mbajtur me huapërdorje. Ata kanë jetuar në këtë banesë për vitet 2005-2015, deri kur lidhëm kontratë për cedim të drejtash, ku edhe aktualisht banojnë në dijeninë time”.

15.10 Në vijim, palët përkatëse (ceduesi dhe cesionari), në datën **.6.2016, kanë nënshkruar dokumentin noterial me nr. *** rep., nr. *** kol.: “Saktësim Kontrate”, në të cilën kanë rënë dakord se: “Në mbështetjeje të kontratës së cedimit me nr. *** dhe kol ***, dt. **.3.2016, ne si palë në paragrafin e deklarimeve paraprake dhe konkretisht në pikën katër të këtij paragrafi, gabimisht kemi shënuar që shumën prej 50.000 dollarësh amerikanë, që i janë likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi. Ky paragraf është gabim i shkruar nga ana jonë, pasi të hollat prej 50.000 dollarësh amerikane janë dhënë nga ceduesi te sipërmarrësi dhe jo nga përfituesi, prandaj në këtë paragraf shprehja: “i janë dhënë nga përfituesi” duhet hequr dhe është e gabuar. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tjera të përcaktuara në kontratën e cedimit janë në fuqi pa asnjë ndryshim në mes nesh si palë”. Duke lënë kështu në fuqi pikën 6¹⁴ dhe 7¹⁵, të kontratës së cedimit, rubrika “Deklarime paraprake”. Fakti i përmbushjes së detyrimeve kontraktuale të kontratës së sipërmarrjes së prillit 2003, nga ana e subjektit të rivlerësimit, rezultoi i provuar edhe nga hetimi gjyqësor referuar vendimit nr. ***, datë **.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, të sipërcituar, në të cilin përcaktohet se: “Megjithëse ceduesi ***.***, dhe paditësi ***.*** i kanë përmbushur plotësisht detyrimet që burojnë nga kontrata e sipërmarrjes me nr. *** rep., datë **.4.2003, nga ana tjetër, Shoqëria “***” sh.p.k., nuk ka përmbushur detyrimet kontraktore...¹⁶”.

15.11 Për sa i përket marrëdhënies me shtetasin ***.*** ka rezultuar se në DV-2008, subjekti ka deklaruar huadhënie me interes në shumën 40.000 euro, por pa deklaruar huamarrësin dhe vetëm në procesverbalin e ILDKPKI-së së datës **.5.2016, si dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti ka deklaruar se shtetasi ***.*** është bashkëshorti i motrës së tij dhe kjo shumë i është dhënë *cash* dhe nuk i është kthyer.

15.12 Për të provuar marrëdhënien e huas, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., të datës **.3.2009, me deklarues subjektin e rivlerësimit, në të cilën ky i fundit deklaroi se i ka dhënë z. ***.***, shumën prej 40.000 euro në datën **.7.2008. Kjo shumë do të kthehet në një afat të pacaktuar kundrejt një interesi mujor prej 1.5%. Në rast mospagimi të interesit mujor, kjo shumë do të kthehet menjëherë. Në DV-2008¹⁷ dhe 2009, subjekti ka deklaruar dhe përfitimin e interesave në shumat 600 euro në muaj.

15.13 Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me rrethanat faktike si më sipër, Komisioni i ka kaluar barrën e provës dhe ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me:

¹⁴ Përfituesi ka paguar për blerjen e të drejtave të apartamentit sipas parashikimeve të përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes.

¹⁵ Duke pasur parasysh atë çka përmendet më lart, palët kanë rënë dakord të hyjnë në këtë kontratë për transferimin e të drejtave mbi apartamentin që lindin nga kontrata e sipërmarrjes dt. **.4.2003.

¹⁶ Për më tepër referohuni në f. 3 të arsyetimit të këtij vendimi.

¹⁷ Në DV-2008, subjekti deklaroi: të ardhura nga interesat e huadhënies 3.000 euro, gjendje *cash* nga interesat e huas, 5 muaj x 600 euro, 3.000 euro. Ndërsa në DV-2009, ka deklaruar të ardhura nga interesat e huadhënies 4800 euro, si dhe gjendje *cash* nga interesat e huas 8 muaj x 600 euro.

(i) Mospërputhjet e deklarimeve të bëra për momentin e fillimit të banimit të familjes së subjektit në apartamentin e ndodhur në rrugën “*** **”, Tiranë¹⁸.

(ii) Dyshimit të arsyeshëm se kemi të bëjmë me pasuri të porositur dhe paguar nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2003, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tij, por se kontrata e porosisë është lidhur në dukje në emër të z. ***.***, me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimit të ligjshmërisë së burimeve, të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes të saj, në kushtet kur duket se: a) porositësi/blerësi fillestar i kësaj pasurie nuk e ka përdorur asnjëherë atë; b) subjekti dhe familja e tij e kanë përdorur pa kundërshtpërblim këtë pasuri për një periudhë prej rreth 12-vjeçare; c) në kontratën e cedimit të të drejtave, datë **.3.2016, ndër të tjera, është përcaktuar se: “*Ceduesi deklaron se pagesat e këtyre 3 kësteve në vlerë totale 50.000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi*”; ç) nga njëra anë subjekti deklaron se e ka përdorur pa kundërshtpërblim këtë pasuri, ndërkohë, nga ana tjetër, në vitin 2008 i ka dhënë hua me interes shtetasit ***.***, i cili i kishte lënë në përdorim këtë pasuri; d) në kontratën e cedimit të të drejtave përcaktohet i njëjti çmim i paguar nga subjekti (si përfitues) në vitin 2016, me atë të cilin kishte paguar ceduesi në vitin 2003¹⁹.

(iii) Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të provojë të ardhurat e personit tjetër të lidhur ***.***, të cilat kanë shërbyer për kryerjen në vitin 2003 të pagesave për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke e thirrur këtë të fundit edhe në cilësinë e dëshmitarit (procesverbali i datës **.1.2023).

15.14 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës **.2.2023, iu ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke ridekluar se pasuria është blerë nga z. ***.***, provuar me mandatpagesat e depozituara në dosje. Lidhur me burimet e të ardhurave të shtetasit ***.***, për kryerjen e këtyre pagesave, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer të ardhurat e përfituara prej tij nga punësimi dhe nga shitja e dy pasurive në Kukës, duke vënë në dispozicion kontratat e shitjes, akte nga institucionet financiare (*** Bank dhe *** Bank), dhe akte mbi të ardhurat nga puna e këtij shtetasi²⁰.

15.15 Komisioni ka vendosur riçeljen e hetimit administrativ me qëllim kryerjen e një analize për mundësinë financiare të shtetasit ***.***, për likuidimin e çmimit të blerjes të pasurisë objekt vlerësimi, deri në momentin e kryerjes së pagesave, datë **.12.2003. Në përfundim, pasi ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare të burimeve të ligjshme të shtetasit ***.***, Komisioni, sërish, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegimet/argumentet e tij përfundimtare, si dhe për të depozituar prova të reja të mundshme mbi të ardhurat e personit tjetër të lidhur, z. ***.***, dhe/apo

¹⁸Në deklaratimet periodike të viteve 2004 – 2016, subjekti ka deklaruar si adresë banimi këtë pasuri, ndërsa në ILDKPKI, sipas “procesverbalit mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, të datës ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2006. Gjatë hetimit, subjekti ka depozituar deklaratën notoriale të datës **.7.2020, të shtetasve ***.*** dhe ***.*** (kupati dhe e motra), të cilët kanë deklaruar se subjekti dhe familja e tij kanë banuar në apartamentin e tyre (pasuria objekt vlerësimi) prej vitit 2005 e në vijim.

¹⁹ Referuar Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave: “*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016*”, duket se sipas vlerës mesatare të banesave në tregun e lirë për zonën ku ndodhej pasuria objekt vlerësimi, konkretisht në rrugën “*** **”, Tiranë, çmimi për metër katror për këto zona, varionte nga 132.000 lekë/m² deri në 190.000 lekë/m². Pra, duket se vlera e tregut për këtë apartament në vitin 2016 ishte midis vlerës 12.766.208 lekë dhe 18.390.100 lekë.

²⁰ Referohuni shpjegimeve të subjektit të datës 20.2.2023 dhe akteve bashkëlidhur.

familjarëve të tij, analizuar kjo rrethanë si një nga elementet në vlerësimin përfundimtar të situatës së dyshuar për fshehje pasurie.

15.16 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e paraqitura, ka ritheksuar se kjo pasuri është blerë prej tij në vitin 2016, pra nuk i është dhuruar nga shtetasi ***.***. Dhe, në këtë kontekst, argumenton se ky shtetas nuk mund të cilësohet si person tjetër i lidhur, i cili ka detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të pasurisë, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi, në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka pretenduar rishikimin e disa zërave të analizës financiare të kryer nga Komisioni, konkretisht: (i) të ardhurat e llogaritura të përfituara nga shitja e dy pasurive në Kukës, pasi vlera e pasqyruar në kontratat respektive nuk përfaqëson vlerën reale të shitjes; (ii) të ardhurat e përfituara nga punësimi, komisionet dhe bonuset pranë shoqërive *** dhe ***; (iii) të ardhurat e pretenduara të përfituara nga këmbimi valutator në vitet 1998 e në vazhdim; (iv) të ardhurat shtesë për shtetasen ***.***, për vitet 2002 dhe 2003, sipas vërtetimeve të paraqitura mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë; si dhe (v) prova të reja mbi likuiditetet të tjera në llogaritë bankare sipas konfirmimeve të këtyre institucioneve²¹.

15.17 Komisioni, në përfundim lidhur me këtë pasuri, duke u bazuar në bindjen e brendshme dhe duke i gjetur të drejta prapësimet e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera²², për mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimeve financiare të familjes ***, ka vlerësuar se ata kanë pasur një situatë të shëndetshme financiare për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer gjatë vitit 2003. Komisioni arsyeton se ky konkluzion duhet pranuar se është arritur në kushtet e një niveli më të ulët provueshmërie, për sa kohë z. ***.*** nuk bën pjesë në rrethin e personave të lidhur, sipas parashikimit të bërë në pikën 13, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, apo në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32/4 të po këtij ligji dhe, si rrjedhojë, nuk kërkohet që të përmbushet detyrimi kushtetues për justifikimin e ligjshmërisë së pasurive, sipas nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës, duke sjellë në vëmendje këtu se analizimi i burimeve financiare të familjes ***, për blerjen e kësaj pasurie është kryer në funksion të verifikimit të situatës së dyshuar për pasuri të fshehur. Në këto kushte, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

16. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së të datës 2.5.2023, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me vlerësimin e situatës faktike për fshehjen e pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pika 5, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm edhe për sa i përket vlerësimit të situatës financiare, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë *apartment banimi*, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar si më poshtë.

16.1 Komisioneri Publik vlerëson se faktet dhe provat e administruara lidhur me pasurinë *apartment* janë të tilla që drejtojnë në një përfundim të kundërt me atë që ka arritur Komisioni, i cili duket se është bazuar më së shumti në bindjen e tij të brendshme, lidhur me përpjekjen e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur në mënyrë të pasaktë apo të fshehtë marrëdhënien e

²¹ Referohuni shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit të datës ***.3.2023 dhe akteve bashkëlidhur.

²² Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 12-18, të vendimit.

vërtetë juridike me pasurinë objekt vlerësimi. Subjekti i rivlerësimit, që prej momentit të vendosjes së tij në posedim të kësaj pasurie, të paktën që prej vitit 2004, bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, ku parashikohet detyrimi për deklarim të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare për: a) *pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil*, duhet të deklaronte marrëdhënien apo aktin nga i vinin këto të drejta reale apo të mira juridike të sendit.

16.2 Sjellja e subjektit të rivlerësimit me pronën në këtë rast, gëzimi dhe përdorimi i saj jo prej pronarëve të pretenduar, por prej subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij, të paktën deri në mars të vitit 2016, moment kur subjektit të rivlerësimit i kalojnë të drejtat e ceduesit, kunatit të tij, z. ***.***, në raport me gjithë provat e tjera të analizuara, duket si një raport i zhdrejtë për sa i përket asaj që subjekti pretendon apo ofron në këmbim të këtij përfitimi. Këto rrethana demonstrojnë sjelljen si pronar të subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri që në krye të herës që është vendosur në posedim. Ky vlerësim vjen si përfundim logjik i fakteve dhe i rrethanave të marra në analizë, trajtuar edhe më sipër, ku rezulton se porositësi/blerësi, shtetasi ***.***, nuk e ka përdorur asnjëherë pasurinë objekt vlerësimi, ndërkohë nga dëshmia e tij dhënë përpara Komisionit, ka deklaruar se jetonte me qira në momentin e blerjes së pasurisë *apartment*, përpara se të përfundonte banesën private të tij, ndodhur te ***, ku dhe aktualisht banon.

16.3 Konstatohen deklarime kontradiktore lidhur me përdorimin e kësaj pasurie për 12 vjet pa shpërblim nga ana e subjektit, si dhe lidhur me marrëdhënien e huas me shtetasin ***.***, deklaruar me interes 1.5% në muaj. Deklarimet e subjektit²³ lidhur me këtë marrëdhënie nuk përputhen me deklaratimet në dëshminë e shtetasit ***.***²⁴. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në DV-2008, për marrjen me qira të kësaj pasurie nuk është i plotë, pasi në këtë deklaratë, në seksionin ku kërkohet të deklarohet vendbanimi, subjekti krahas adresës si më sipër, ka shtuar “(me qira)”, pa specifikuar më tej ndonjë element tjetër. Në kontratën e cedimit të të drejtave të datës *.3.2016, ndër të tjera, parashtrohet se: “*Ceduesi deklaron se pagesat e këtyre tre kësteve në vlerën totale prej 50.000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga Përfituesi*”. Saktësimi i kësaj kontratë është bërë në datën *.6.2016, pasi subjekti është thirrur nga ILDKPKI në datën *.5.2016.

16.4 Një e dhënë tjetër që merr peshë në këtë optikë vlerësimi, është dhe çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri në vitin 2016, i cili sipas kontratës së cedimit është i njëjtë me çmimin e blerjes së saj rreth 12 vite më parë, nga ana e ceduesit, sipas kontratës së sipërmarrjes, ndërkohë që vlera mesatare në tregun e lirë për zonën për këtë pasuri në vitin 2016, është rreth trefish më e lartë se çmimi i përcaktuar. Në këtë kontekst, duket e palogjikshme dhe një raport i shpërpjesëtuar, që palët në këtë marrëdhënie, me një detyrim të pashlyer mes tyre (huaja e pretenduar me interes e vitit 2008) të mos kompensoheshin apo të dakordësonin ndërshtyerjen, duke konsideruar diferencën e ndjeshme në çmim në momentin e

²³ Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. **, ka deklaruar se: “... fakti i dhënë se kam qenë me qira në vitin 2008 është se shtetasi ***.*** më kishte huan prej 40.000 euro me përqindje dhe meqenëse nuk më jepte interesat, qiraja konsiderohej e shlyer nga ana ime. *** kishte disa vite që nuk jepte interesat dhe shumën e huas sipas deklaratës së bërë mes nesh. Kjo është pasqyruar edhe në DV-2010, ku nuk është deklaruar më tej interesi. Edhe sot e kësaj dite nuk është kthyer huaja”.

²⁴ Ky shtetas në dëshminë e tij përpara Komisionit ka deklaruar se: “... apartamenti i është lënë subjektit në kuadër të marrëdhënieve të ngushta familjare...”, ndërsa për sa i përket huas prej 40.000 euro, shtetasi ***.*** ka qenë i paqartë mbi shumën e shlyera.

shitjes (gati trefishi). Vlen të theksohet, gjithashtu, se nuk ka asnjë provë që shuma prej 50.000 USD të jetë transferuar/paguar nga subjekti i rivlerësimit tek z. ***.***, si detyrim i kontratës së cedimit të të drejtave.

16.5 Në vlerësimin si më sipër, mbahet në konsideratë edhe situata faktike e konstatuar nga hetimi administrativ, se për blerjen e kësaj pasurie deri në vitin 2003, porositi në dukje, shtetasi ***.***, është në kushtet e pamjaftueshmërisë dhe mungesës së të ardhurave të ligjshme, barrë prove kjo, e cila nuk është përmbysur nga ana e subjektit të rivlerësimit, si përdoruesi i vetëm i kësaj pasurie dhe aktualisht pronar i saj. Komisioni, në këtë drejtim, duket se arsyeton në mënyrë të pamjaftueshme dhe jo të qartë, e për këtë qëllim, sikurse vlerësohet edhe në rekomandimin e ONM-së, çmujmë të nevojshme kryerjen e një analizë tërësore dhe të saktë lidhur me ligjshmërinë e burimeve të deklaruara për blerjen e pasurisë *apartment banimi*. Komisioneri Publik, duke mbajtur në konsideratë faktin se kjo është një marrëdhënie përdorimi, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit²⁵, vlerëson se edhe pse kjo marrëdhënie nuk mund të kualifikohet si nënkategori e parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr.84/2016, kjo, në kuadër të parashikimit në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, duhet të analizohet dhe evidentohet saktë marrëdhënia juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në përdorim, për të verifikuar çdo rrethanë që justifikojnë dyshimin në këtë rast për fshehjen e pasurisë, që mund të rezultojë të jetë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në analizën financiare të kryer, Komisioni ka marrë në konsideratë apriori pretendimet e subjektit të pambështetura në aktet e administruara në dosje, duke arritur në përfundimin e gabuar që kunati i subjektit të rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë me vlerën 50000 USD.

16.6 Duke iu rikthyer analizës financiare, konstatojmë se fillimisht nga analiza paraprake e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se familja *** ka realizuar të ardhura të ligjshme për periudhën 1994-2003, nga pagat dhe shitja e pasurive në Kukës, në shumën totale prej rreth 4.9 milionë lekë, të cilat janë të pamjaftueshme për të justifikuar blerjen e pasurisë llogaritur në vlerën rreth 6 milionë lekë dhe njëkohësisht shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë, pa llogaritur këtu shpenzime të tjera lidhur me ndërtimin e banesës, ku z. ***.***, aktualisht, jeton (deklaruar në zonën e ***). Vlerësimi i Komisionit mbi përfshirjen në mesin e burimeve të ligjshme të familjes ***, të ardhura shtesë të pretenduara si të përfituara në formën e komisioneve/bonuseve nga punësimi pranë shoqërive të sigurimeve “****” dhe “***”, mbështetur vetëm në deklaratat e këtyre dy shoqërive, të lëshuara gjatë hetimit administrativ, të cilat për më tepër nuk referojnë as vlerë/shumë të përfituar, gjendet i pabazuar. Këto të ardhura mbeten në nivel deklarativ dhe nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D, pika 3 të aneksit të Kushtetutës.

16.7 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, i pabazuar gjendet dhe konsiderimi nga Komisioni i shumave të përfituara të z. ***.***, nga shitja e dy pronave në Kukës, bazuar në pretendimet e subjektit (për një vlerë 2.5 herë më të lartë), në krahasim me vlerën e përcaktuar në kontratat noteriale të depozituara nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ. Ky vlerësim gjendet në kundërshtim me jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit mbi vlerën provuese të akteve zyrtare, kontrata shitje hartuar përpara noterit publik. I pambështetur konsiderohet në

²⁵ Shihni vendimin e KPA-së (JR) nr. 10, datë 14.4.2022.

vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe marrja në konsideratë e shumave të depozituara pranë *** Bank dhe *** Bank, sipas konfirmimeve të këtyre të fundit, depozita për të cilat edhe pse duket se kanë qenë aktive dhe janë tërhequr (depozita pranë *** Bank), gjatë periudhës deri në dhjetor 2003, nuk rezulton të jetë provuar ligjshmëria e burimit të krijimit të tyre dhe destinacioni i tyre.

16.8 Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në analizën e fakteve dhe rrethanave si më sipër, duke vlerësuar sjelljen e subjektit në raport me këtë pasuri, çmon se subjekti i rivlerësimit ka qenë poseduesi dhe pronari *de facto* i pasurisë *apartament banimi*, rruga “****”, Tiranë, që prej vitit 2004, duke e legalizuar/formalizuar këtë marrëdhënie vetëm në vitin 2016. Rrethanat e mësipërme çojnë në aplikimin e nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila duhet të vlerësohet edhe në vështrim të nenit 4, pika 2, në lidhje me nenin 61, pika 5 e këtij ligji.

17. Të ardhura në shumën 40.000 euro, si rezultat i shitjes së aksioneve të bashkëshortes së ndjerë pranë shoqërisë “**” sh.a., Dega Kosovë**

17.1 Në *D-Vetting*, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar: *aksione në vlerën 1%* (depozituar në vlerën 12.500 euro), të vlerës së përgjithshme të aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., Dega Kosovë, të vëna në datën **.12.2005 nga bashkëshortja, e ndjera ***.***, të përfituara prej tij si trashëgimtar. Gjithashtu, në seksionin e deklarimit të të ardhurave të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar të ardhurat në vlerën *neto* prej 40.000 euro, të përfituara me trashëgimi nga shitja e aksioneve në masën 1%, të cilat disponoheshin nga bashkëshortja e tij e ndjerë, ***.***. Lidhur me këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ia ka dhënë hua shtetasit ***.***, me interes 1.5% në vit. Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në Deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratën periodike vjetore, burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për investimin në aksione në vitin 2005.

17.2 Në deklaratimet periodike të viteve 2005 dhe 2006, nuk rezulton të jenë deklaruar aksione apo investime të tjera të kësaj natyre të kryera nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, e ndjera ***.***.

17.3 Në *DV- 2007*, subjekti ka deklaruar aksione në shoqërinë “****” sh.a. Kosovë, depozituar nga bashkëshortja në dhjetor të vitit 2005, në shumën prej 12.500 euro, me shënimin: “*vënë në dijeni në vitin 2007 nga kompania, pas vdekjes së bashkëshortes*”. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar se një pjesë e vlerës është marrë nga bashkëshortja prej motrës së saj (pa deklaruar shumën e marrë hua). Në vijim, në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar një depozitë në Bankën ***, në shumën prej 44.463 euro, në emër të shtetasës ***.*** (bashkëshortja e ndjerë), vlerë e krijuar nga shitja e aksioneve të “****” sh.a., për të cilën deklaron se *do të tërhiqen kur të çelet dëshmia e trashëgimisë*. Pjesa takuese: 25%.

17.4 Në seksionin e të ardhurave të *DV- 2007*, subjekti ka deklaruar: *të ardhura nga shitja e aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., në emër të bashkëshortes, shuma 44.463 euro*. Në seksionin e detyrimeve të kësaj deklarate, me një akt i cili duket se është depozituar në ILDKPKI në datën ** .11.2008²⁶, subjekti ka deklaruar: *detyrimi i mbetur ndaj motrës nga*

²⁶ Datë në të cilën subjekti është thirrur për të dhënë shpjegime pranë ILDKPKI-së sipas procesverbalit të administruar në dosje.

huamarrja e marrë prej bashkëshortes ***.*** që në vitin 2005, në shumën 1.000.000 lekë, nga e cila, pas vdekjes së saj, e motra i fali 400.000 lekë dhe prej tij është shlyer vlera 200.000 lekë në vitin 2006. Pjesa e mbetur në shumën 400.000 lekë vazhdon të mbetet detyrim pa interes dhe pa afat²⁷.

17.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, rezulton se pasi është pyetur nga ILDKPKI-ja në datën *.11.2008²⁸, në lidhje me mosdeklarimin në kohë të këtyre aksioneve, subjekti ka deklaruar se: “... në dhjetor të vitit 2005, bashkëshortja e tij, ***.***, ka investuar si punonjëse e “****” sh.a. në Degën Kosovë shumën prej 12.500 euro, sipas vërtetimit të lëshuar nga kjo shoqëri, datë *.11.2008, pa dijeninë e tij. Pas vdekjes së bashkëshortes në vitin 2006, është vënë në dijeni nga “****” sh.a. se bashkëshortja e tij, ***.***, ka pasur aksione në shumën 12.500 euro. Si burim krijimi e kësaj shume sqaron se: “... bashkëshortja e tij, që në vitin 2005, ka marrë, pa dijeninë e tij, një huamarrje në shumën 1.400.000 lekë dhe, konkretisht, motrës së saj ***.***, në shumën 400.000 lekë dhe motrës së tij ***.***, shumën 1.000.000 lekë”. Në vijim të deklarimit, subjekti ka shpjeguar se: “... ka shlyer në total detyrimin ndaj kunatës ***.***, në shumën 400.000 lekë që në vitin 2006, ndërsa detyrimi ndaj motrës në shumën 1.000.000 lekë ka zbritur, pasi ajo i ka falur një pjesë të detyrimit në shumën 400.000 lekë dhe ka shlyer shumën 200.000 lekë, ndërsa vazhdon detyrimi i mbetur ndaj motrës në shumën 400.000 lekë”²⁹.

17.6 Për sa më sipër, në kushtet kur: (i) një nga huadhënëset e deklaruara është motra e subjektit; (ii) vetë subjekti ka deklaruar se ka shlyer një pjesë të huave të marra nga bashkëshortja e ndjerë e tij që në vitin 2006; (iii) shtetasi ***.*** (bashkëshorti i motrës), të cilit subjekti i kishte marrë në përdorim shtëpinë, ka qenë i punësuar në të njëjtën shoqëri dhe ka kryer të njëjtin investim në të njëjtën periudhë; si dhe faktit se: (iv) duket se subjekti kishte njohje me një nga drejtorët e shoqërisë³⁰, Komisioni ka ngritur dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e deklarimit të bërë nga subjekti për padijeninë e tij në momentin e investimit të kryer nga bashkëshortja e ndjerë ***.***, në dhjetor të vitit 2005. Në vijim, Komisioni, duke i konsideruar persona të tjerë të lidhur huadhënëset ***.*** (motra e bashkëshortes së ndjerë) dhe ***.*** (motra e subjekti), në përputhje me pikën 14, të nenit 3 dhe nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza financiare, bazuar në aktet dhe shpjegimet e vëna në dispozicion nga subjekti mbi këtë çështje, ka konstatuar se: “... duket se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme, për të mundësuar krijimin e shumave prej 1.000.000 lekë dhe 400.000 lekë, të deklaruara si të dhëna hua në vitin 2005, në favor të bashkëshortes së ndjerë të subjektit, znj. ***.***”. Në këto kushte, Komisioni bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime dhe prova në lidhje me faktin e mosdeklarimit në DV-të e viteve 2005, 2006 dhe

²⁷ Një pjesë e deklarimeve të bëra lidhur me vlerën e aksioneve, burimin e krijimit dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tyre janë bërë me shtesë deklarimi të DV-2007, në datën *.11.2008.

²⁸ “Procesverbali mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, i datës *.11.2008, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë *.7.2022, e ILDKPKI-së, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë *.7.2022.

²⁹ Në mbështetje të sqarimeve të dhëna, subjekti ka paraqitur në ILDKPKI vërtetimin e datës *.11.2008, të shoqërisë “****” sh.a., në referim të të cilit konfirmohet se: “Znj. ***.*** ka investuar si punonjëse e shoqërisë “**** sh.a., në Degën Kosovë, shumën 12.500 euro. Pas shitjes së një pjese të aksioneve të shoqërisë “**** sh.a., kompanisë “****, në vitin 2007 dhe mbyllet së investimit në Kosovë, z. ***.*** ka përfutur kthim nga ky investim në shumën 44.463 euro. Për këto të ardhura i janë mbajtur detyrimet ndaj shtetit”.

³⁰ Bazuar në deklaratimet e dëshmitarit ***.***, përpara Komisionit, në datën *.1.2023.

2007, të investimit të kryer nga personi i lidhur në shoqërinë “****” sh. a., si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e këtij investimi.

17.7 Subjekti, në prapësimet e tij, iu ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke ritheksuar se ai nuk ka pasur dijeni në momentin e kryerjes së investimit nga bashkëshortja e tij e ndjerë, ***.***, të shumës 12.500 euro, në dhjetor të vitit 2005, por se është njoftuar nga punonjës të shoqërisë “****” sh. a., pasi bashkëshortja e tij kishte ndërruar jetë. Në vijim të prapësimeve, subjekti ka deklaruar se pavarësisht se deklarimet e tij të para mbi këtë investim janë bërë në DV-2007 (me deklarimet shtesë të bëra gjatë vitit 2008), ai kishte marrë dijeni më përpara për këtë investim dhe ende më herët për huat e marra nga bashkëshortja e ndjerë në fund të vitit 2005. Subjekti referon se në vitin 2006, pas vdekjes së bashkëshortes, mori dijeni për dy huat dhe ka deklaruar shlyerjen pjesore të tyre. Më tej, në vitin 2007, ka marrë dijeni për investimin e kryer nga bashkëshortja dhe shumën që do të kthehej nga ky investim, pasi është njoftuar nga punonjësit e shoqërisë “****” sh.a. Subjekti ka argumentuar se deklarimi i këtij investimi në ILDKPKI është bërë prej tij në momentin që kishte një konfirmim zyrtar nga shoqëria mbi shumën e investuar, si dhe mbi shumën e përfituar. Për burimin e shumës së investuar, nisur nga vlera e saj dhe fakti që ai dispononte likuiditete *cash* para investimit, sipas subjektit janë të dhëna që tregojnë qartë që ai nuk ka pasur dijeni për këtë investim. Lidhur me mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për t’i dhënë bashkëshortes së ndjerë huat e pretenduara, subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, ka kërkuar rishikimin e analizës financiare të kryer për huadhënësit³¹.

17.8 Komisioni, në përfundim, i ka vlerësuar bindëse pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi padijeninë e tij në momentin e kryerjes së investimit nga bashkëshortja, e ndjera ***.***, në dhjetor të vitit 2005³², duke arsyetuar mbi bazën e qëndrimit të mbajtur nga Kolegji, se pasaktësitë në deklarimet periodike, për sa kohë nuk shoqërohen me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi.

17.9 Për sa i përket marrëdhënieve me huadhënëset, Komisioni konstaton se subjekti ka depozituar deklaratat noteriale të këtyre shtetaseve, të cilët pranojnë dhënien hua të këtyre shumave në vitin 2005, si dhe kanë deklaruar burimin e të ardhurave të tyre. Komisioni, edhe në këtë rast, bazuar në bindjen e brendshme, i ka gjetur të drejta pretendimet e subjektit të

³¹ (i) Për sa i përket të ardhurave të familjes së motrës së tij, ***.***, në referim të provave të depozituara³¹, subjekti pretendon se ekonomia e tyre është e qëndrueshme dhe me likuiditetet të mjaftueshme, të cilat justifikojnë plotësisht shumën prej 1 milion lekë, që ia kanë dhënë ish-bashkëshortes së ndjerë. Burimi i të ardhurave të tyre ka qenë kryesisht të ardhurat nga punësimi, biznesi “bar-kafë” dhe të ardhurat nga aktiviteti në bujqësi. Në mungesë të kohës së mjaftueshme për të kërkuar dhe realizuar kryerjen e një akt-ekspertimi mbi të ardhurat e mundshme të përfituara nga bashkëshorti i motrës në bujqësi, subjekti ka kërkuar që, minimalisht, në analizën financiare të personit tjetër të lidhur të reduktohen shpenzimet bazë ushqimore dhe për pije joalkoolike, kjo edhe për shkak se, sipas tij, shpenzimet në rrethin e Kukësit nuk janë të njëjta si ato në rrethin e Tiranës. Subjekti ka pretenduar dhe huamarrje të familjes *** nga shtetasi *** ***, e cila ka shërbyer si një nga burimet e krijimit të huas së deklaruar. (ii) Për sa i përket të ardhurave të huadhënësës tjetër, znj. ***.*** (motrës së bashkëshortes së ndjerë), subjekti, përveç sa ka depozituar gjatë hetimit, me përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ ka vënë në dispozicion si provë të re dhe dokumentin e lëshuar nga *** Bank me nr. *** prot., datë **.2.2023, i cili konfirmon marrjen nga ana e bashkëshortit të znj. ***.*** të dy kredive në shumën 200.000 lekë, në datën **.12.2005 dhe 200.000 lekë, datë **.12.2005, duke pretenduar se dhe të dyja këto kredi bankare duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme të huadhënësve. Subjekti pretendon se, megjithëse vërehet që një nga kreditë është marrë një ditë pas depozitimit të shumës nga ish-bashkëshortja e tij, kunata i ka thënë se, edhe këtë shumë, ia ka dhënë motrës, pasi ajo i kishte thënë që ia kishte marrë një kolegu të saj te puna sa për një ditë, për të kryer investimin.

³² Referohuni f. 28-36, të vendimit të arsyetuar.

rivlerësimit për rishikimin e analizës financiare, lidhur me justifikimin e ligjshmërisë së burimit të huave të deklaruara³³.

18. Komisioneri Publik, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, çmon se përfundimi i Komisionit nuk është rrjedhojë e një vlerësimi tërësor të fakteve dhe interpretimit të drejtë të ligjit të posaçëm, duke analizuar si më poshtë:

18.1 *Së pari*, lidhur me mungesën e dijenisë së subjektit mbi investimin nga ana e bashkëshortes së ndjerë, duket se deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, në procesverbalet e mbajtura në ILDKPKI lidhur me këtë çështje, si dhe gjatë hetimit administrativ, janë kontradiktore dhe jo bindëse, si për investimin e kryer, ashtu dhe për burimet e përdorura për këtë investim. Kështu, në deklaratën periodike dorëzuar në ILDKPKI në datën **.2.2008, në f. 3 të saj, subjekti ka deklaruar si burim vetëm huan nga e motra e bashkëshortes së ndjerë, znj. ***.**, pa specifikuar shumën e marrë hua, ndërsa në f. nr. **, të kësaj deklarate, e cila mban në fund të saj shënimin me shkrim dore **.11.2008, subjekti si detyrim të mbetur, ka deklaruar shumën 400.000 lekë, detyrim i cili edhe pse nuk specifikohet se kujt individit i takon, duket se lidhet me huan e pretenduar marrë motrës së subjektit, bazuar në pretendimet e tij në procesverbalet mbajtur në ILDKPKI, si dhe gjatë hetimit administrativ, pra znj. ***.**. Kjo e fundit, referuar deklaratës noteriale të depozituar në Komision nga ana e subjektit, duket se paraqet deklarime kontradiktore lidhur me detyrimin e mbetur nga kjo hua. Kështu, në deklaratën noteriale të datës **.11.2022, huadhënësja, ***.**, deklaroi se: “... nga kjo shumë (duke iu referuar huas së dhënë prej 1.000.00 lekë) vëllai im, ***.**, më ka kthyer në vitin 2006 shumën prej 200.000 lekë, shumën prej 400.000 lekë, vëllai im ma ka kthyer në vitin 2009 (me sa mbaj mend unë). Ndërsa shumën prej 400.000 lekë deklaroj se ia kam falur...”, ndërsa në deklaratën noteriale të datës **.12.2022, huadhënësja, ***.**, përpara të njëjtit noter, deklaroi se: “... kjo shumë (duke iu referuar huas së dhënë prej 1.000.00 lekë) më është kthyer totalisht nga vëllai im, ***.**, në vitin 2010 (arrita në këtë përfundim pasi u konstatova dhe me familjarët e mi”.

18.2 *Së dyti*, vlen të theksohet se deklaratimet e bëra mbi faktin se shuma është shlyer nga subjekti respektivisht 200.000 lekë në vitin 2006 dhe 400.000 lekë në vitin 2009, nuk gjejnë pasqyrim në asnjë nga deklaratat periodike të subjektit depozituar pranë ILDKPKI-së, përveç deklaratimit të shtuar në datën **.11.2008, ku subjekti deklaroi detyrimin e mbetur ndaj motrës në shumën 400.000 lekë.

18.3 *Së treti*, për sa i përket burimit të ligjshëm të të ardhurave të huadhënësës tjetër, znj. ***.**, sikundër ka rezultuar nga analiza e kryer nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, znj. ***.** dhe bashkëshorti i saj kanë realizuar të ardhura nga punësimi, të cilat duket se janë të mjaftueshme vetëm për përballimin e shpenzimeve minimale jetike të tyre për periudhën në fjalë. Pretendimi i subjektit se bashkëshorti i huadhënësës ka marrë pranë *** Bank dy kredi në shumat totale prej 400.000 lekë, në periudhën dhjetor 2005, për të cilat është paguar interesi respektiv sipas kushteve të bankës, të cilat më pas i janë dhënë bashkëshortes së ndjerë të subjektit hua, pa interes, për t’u investuar në një fond për të cilin dhe janë gjeneruar fitime të konsiderueshme, përveçse një burim i shtuar vetëm pas kalimit të barrës së provës, duket

³³ Komisioni, edhe pasi ka marrë në konsideratë dy huat e deklaruara marrë nga bashkëshortja e ndjerë nga dy personat e tjerë të lidhur, i ka rezultuar pamjaftueshmëri financiare e subjektit dhe personit të lidhur me të, në vitin 2005, në shumën -527.339 lekë, e cila do të trajtohet në vijim.

alogjik dhe i pambështetur dhe në vetë deklaratën noteriale të znj. ***.***, të datës **.11.2022. Në këtë deklaratë, znj. ***.***, deklaroi se: “... këtë shumë të hollash e kam pasur nga kursimet e mia familjare e punësuar si mësuese në shkollën jopublike ‘***.***’, në qytetin e Lushnjës, si dhe nga punësimi i bashkëshortit tim si mësues”.

18.4 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar dhe nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të huadhënësës ***.***, të deklaruara të përdorura për investimin e vitit 2005, në aksionet e shoqërisë “****” sh.a.

18.5 Bazuar në sa më sipër, pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga Komisioni për vitin 2005³⁴, në shumën prej të paktën - 927.339 lekë (duke mos marrë në konsideratë në mesin e burimeve të ligjshme huan prej 400.000 lekë të pretenduar nga huadhënësja ***.***), do të thellohej edhe më tej, duke marrë në konsideratë edhe mospërputhjet e deklarimeve të huadhënësës tjetër znj. ***.***, sikundër trajtuar më sipër.

18.6 Duke përfunduar, lidhur me të ardhurat e deklaruara si të fituara nga investimi në vitin 2005 në aksionet e shoqërisë “****” sh.a., Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, si në deklaratën “Vetting” ashtu dhe në deklaramet periodike vjetore dorëzuar ndër vite, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

19. Mbi vlerësimin e burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe investimet e periudhës 2003-2016, të subjektit të rivlerësimit

19.1 Komisionit, nga analiza financiare e kryer për subjektin e rivlerësimit për vitet 2003-2016, fillimisht i ka rezultuar pamjaftueshmëri e burimeve financiare të ligjshme në shumën rreth - 4.000.000 lekë, pamjaftueshmëri për të cilën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën dhe pas vlerësimit të pretendimeve të subjektit në përgjigje të barrës së provës, pretendime që lidhen kryesisht me burimet e personave të tjerë të lidhur znj. ***.***, dhe znj. ***.***, sikundër trajtuar më sipër, Komisioni³⁵, ndër të tjera, në përfundim ka arsyetuar se: “... Për sa më sipër, pas reflektimit të ndryshimeve të cilat gjenin mbështetje në dokumentacionin justifikues ligjor, referuar rezultatit përfundimtar të analizës financiare, Komisioni konstaton se vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 paraqiten me balancë negative fondesh, për një total të akumuluar prej - 1.577.274 lekësh, nga ku evidentohet se me balancë negative të konsiderueshme paraqiten vitet 2005, 2006 dhe 2007, vite për të cilat subjekti pretendon se ka pasur pasaktësi në deklaramin e likuiditeteve cash, si dhe viti 2009, për të cilin subjekti pretendon të reflektohen të ardhurat e deklaruara nga interesat e huas... Por, duke risjellë në vëmendje se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, kjo edhe për shkak të rrethanave të relatuara më sipër, si dhe në konsideratë të faktit nga ku rezulton se kjo balancë negative është e shpërndarë në vite dhe duket se nuk ka ndikim thelbësor në krijimin e pasurive të materializuara dhe të deklaruara si gjendje në deklaramin e rivlerësimit kalimtar Vetting, trupi gjykues arrin në përfundimin se

³⁴ Referohuni rezultateve në tabelën nr. 3, f. 36, të vendimit të Komisionit.

³⁵ Referohuni në f. 42-44, të vendimit të Komisionit.

ajo nuk është e tillë për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

19.2 **Komisioneri Publik**, në analizë të akteve të administruara, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Komisioneri Publik vlerëson se diferenca negative, përveç sa është konstatuar nga Komisioni, është edhe më e lartë, pasi rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë burimet e ligjshme edhe për personin tjetër të lidhur, huadhënësës ***.***, fakt i cili do të shtonte diferencën negative me të paktën 400.000 lekë³⁶. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe deklaramet kontradiktore mbi huan në vlerën 1.000.000 lekë nga e motra e subjektit, vënë në dyshim ligjshmërinë e kësaj të fundit.

19.3 Nga verifikimi i analizës financiare të kryer nga Komisioni, konstatohen pasaktësi në disa prej zërave, si për shembull, shpenzimet e jetesës për vitin 2007 janë llogaritur jo në përputhje me standardin e përdorur deri tani nga institucionet e rivlerësimit bazuar në korrespondencën me ILDKPKI, të ardhura të përfituara nga pensioni familjar për fëmijët duket se është shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme nga Komisioni për vitet 2006-2016, ndërkohë që nga verifikimi i korrespondencës së Komisionit me institucionet financiare duket se, në vitin 2011, ka kaluar një pjesë e akumuluar e shumë deri në këtë moment në llogarinë e subjektit pranë ***-së, shuma të cilat, nëse do të rishikohen, do të thellojnë diferencën negative të viteve respektive.

19.4 Gjithashtu, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të Kolegjit, konkretisht, vendimet (JR) nr. 38/2021, nr. 19/2022, nr.18/2021 dhe nr. 31/2020, diferenca negative e konstatuar për subjektin e rivlerësimit në shumën -1.577.274 lekë, shtuar këtu dhe diferencën e konstatuar në datë **.3.2016 prej – 342.05 lekë (momenti i shlyerjes së pagesës për blerjen e pasurisë “apartament banimi në Tiranë”), tejkalon dhe nuk justifikon në mënyrë objektive masën e proporcionalitetit të zbatuar deri tani nga Kolegji në raste të ngjashme.

20. Pasuri të padeklaruara në D-Vetting dhe deklaramet periodike vjetore

20.1 Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit/dokumentacionit të administruar nga regjistri noterial Shqiptar (RNSH), kontratat dhe deklaramet e paraqitura nga noterët publikë, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur nga ASHK DV Kukës, me shkresë nr. *** prot., datë **.8.2022, Komisioni ka konstatuar se në momentin e plotësimit të deklaramet për rivlerësimin kalimtar – Vetting, fëmijët e subjektit kanë pasur në pronësi pjesë takuese në disa, (5) pasuri të paluajtshme,³⁷ përfutur me zëvendësim, nga çelja e trashëgimisë në datën **.6.2008, të gjyshit të tyre ***.*** (babai i nënës, i cili ka ndërruar jetë në datën **.4.2007).

³⁶ Në këtë rast diferenca negative do të rezultonte minimalisht në shumën - 2.319.328 lekë (1.577.274 lekë (diferenca negative e konstatuar nga Komisioni për vitet 2004-2009 + 400.000 lekë pamundësia e huadhënësës ***.***, + 342.054 lekë e konstatuar në momentin e blerjes së pasurisë në Kukës, në vitin 2016).

³⁷ Pasuria me nr. *** e llojit *arë*, me sipërfaqe 3.856 m², e ndodhur në ***, Kukës, në bashkëpronësi të ***.***, me 85,72 %, dhe të tre fëmijëve të subjektit, ***.***, dhe ***.***, nga 4,76 % secili. Pasuria me nr. *** e llojit *arë*, me sipërfaqe 13.674 m², e ndodhur në ***, Kukës, në pronësi me të njëjtin raport. Pasuria me nr. *** e llojit *arë*, me sipërfaqe 4.406 m², e ndodhur në ***, Kukës, në pronësi me të njëjtin raport. Pasuria me nr. *** e llojit *arë*, me sipërfaqe 3.612,5 m² e ndodhur në ***, Kukës, në pronësi me të njëjtin raport. Pasuria me nr. *** (***) e llojit *truall*, me sipërfaqe 1.322,5 m², dhe karburant me sipërfaqe ndërtimore 220 m², e ndodhur në ***, Kukës, në bashkëpronësi të ***.*** 83,33 %, dhe të tre fëmijëve të subjektit, ***.***, dhe ***.***, nga 5,56 % secili.

20.2 Komisioni ka analizuar mënyrën e përfitimit të pjesëve takuese të pasurive, ku është ndalur më konkretisht në pasurinë me nr. *** (***) e llojit truall, me sipërfaqe 1.322,5 m², dhe karburant me sipërfaqe ndërtimore 220 m², e ndodhur në ***, Kukës, në bashkëpronësi të ***. *** 83,33 %, dhe të tre fëmijëve të subjektit, ***.***, dhe ***.***, nga 5,56 % secili. Për këtë pasuri janë bërë një sërë veprimesh juridike, trajtuar më gjerësisht në arsyetimin e vendimit të Komisionit, nga ku ka rezultuar, ndër të tjera, se:

- (i) Në datën **.7.2008, të gjithë trashëgimtarët e tjerë (përveç fëmijëve të subjektit) kanë hequr dorë nga trashëgimia ligjore, duke ia lënë pjesën e tyre takuese vetëm shtetasit ***.***;
- (ii) Në datën **.10.2008, pasuria me nr. ***, z. k. ***, regjistrohet në bashkëpronësi sipas pjesëve takuese në emër të ***.*** (kunati i subjektit) 83.33 %, dhe tre fëmijëve të subjektit me nga 5.56 % pjesë takuese secili;
- (iii) Në datën **.11.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë ka lëshuar autorizimin me nr. *** datë, për tjetërsimin e pasurisë së fëmijëve të mitur në favor të subjektit të rivlerësimit Naim Tota;
- (iv) Në datën **.12.2017, dy fëmijët e subjektit të rivlerësimit *** dhe ***.***, kanë lëshuar një prokurë³⁸ të përgjithshme, në të cilën i japin të drejta të plota shtetasit ***.*** për të disponuar për të gjitha pasuritë e tyre të paluajtshme;
- (v) Në datën **.12.2017, djali tjetër i subjektit të rivlerësimit, ***.***, ka lëshuar në SHBA, një prokurë³⁹ të përgjithshme në të cilën i jep të drejta të plota shtetasit ***.*** për të disponuar për të gjitha pasuritë e tij të paluajtshme;
- (vi) Në datën **.12.2018, tre fëmijët e subjektit të rivlerësimit, ***.***, dhe ***.***, të përfaqësuar nga shtetasi ***.*** kanë nënshkruar një deklaratë me nr. *** rep., nr. *** kol., me objekt “heqje dorë pa kundërshtim/falë nga bashkëpronësia mbi pasurinë e paluajtshme” (e cila nuk duket të jetë depozituar pranë ASHK Kukës), duke ia lënë në pronësi 100 %, dajës së tyre, ***.***. Pasuria me nr. 1848 e llojit *arë*, me sipërfaqe 3.856 m,² vijon të jetë në bashkëpronësi.

20.3 I pyetur nga Komisioni për faktin e mosdeklarimit të këtyre pasurive, si dhe mbi investimet mundshme të kryera mbi to, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga ana e fëmijëve të tij është hequr dorë nga këto pasuri, duke dorëzuar dhe disa akte në cilësinë e provës⁴⁰, si dhe duke pretenduar se ka qenë detyrim i dajës së fëmijëve të bënte veprimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e hipotekës, konkretisht të heqjes dorë nga fëmijët e tij mbi këto pasuri. Ndërsa në lidhje me pasuritë të cilat figurojnë ende në bashkëpronësi, subjekti ka pretenduar se ato janë deklaruar prej tyre në ILDKPKI, por se, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë, si edhe i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, nuk ka rezultuar një fakt i tillë.

³⁸ Prokurë e përgjithshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.12.2017, redaktuar nga noteri publik, znj. ***.***.

³⁹ Prokurë e përgjithshme datë **.12.2017, redaktuar nga noteri publik ***.***, me vulë apostile të datës **.1.2018, vërtetim përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe me nr. *** rep., datë **.1.2018.

⁴⁰ Subjekti ka depozituar: (i) vendimin e gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me nr. *** Akti, nr. vendimi ***, datë **.11.2008, si edhe (ii) dokumentin, deklaratë noteriale të datës **.3.2009, në referim të së cilës, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëshortit të shtetasës së ndjerë, ***.*** (***) dhe njëkohësisht si babai i 3 fëmijëve të mitur (trashëgimtarë me zëvendësim), ka deklaruar, ndër të tjera, se si përfaqësues i fëmijëve të tij, heqin dorë nga pasuria *tokë bujqësore*, e fituar në bazë të ligjit 7501., datë 19.7.1991, dhe gjithashtu heqjen dorë nga të gjithë pasuritë e fituara dhe ato që do të përfitohen nga ky ligj, duke ia lënë në pronësi pjesën e tyre takuese vëllait të bashkëshortes së tij, z. ***.***.

Në këto kushte, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

20.4 Subjekti, nëpërmjet prapësimeve të depozituara, iu ka qëndruar deklarimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ, duke sqaruar edhe një herë se nga ana e fëmijëve të tij është hequr dorë nga pasuria që kanë pasur në bashkëpronësi me dajën e tyre, ***.***. Për këtë është paraqitur vendimi gjyqësor me nr. ***, datë **.11.2008, dhe deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2009, duke parashtruar se nga pikëpamja ligjore ka qenë detyrim i shtetasit ***.***, që të bënte veprimet përkatëse për pasqyrimin në regjistrat e hipotekës.

20.5 Komisioni, në përfundim, ka vlerësuar se, bazuar në autorizimin e marrë nga gjykata, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e kujdestarit ligjor, konform nenit 343 e vijues të Kodit Civil dhe neneve 231 - 234 të Kodit të Familjes, ka hequr dorë nga këto pasuri që në vitin 2009, duke vlerësuar kështu se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni të faktit se në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, fëmijët e tij kanë pasur të regjistruar pasuri në bashkëpronësi me dajën e tyre, ***.*** dhe, si rrjedhim, mosdeklarimi i pjesëve të tyre takuese vlerësohet se nuk mund të sjellë pasoja në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

21. Komisioneri Publik, bazuar dhe në rekomandimin e ONM-së, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni. Deklarata noteriale e vlerësuar në këtë rast, e datës **.3.2009, e cila ka si bazë ligjore nenin 333 të Kodit të Civil “Heqja dorë nga trashëgimi”, megjithëse mbetet e paqartë në përmbajtjen e saj, ajo duket se ka ngelur pa fuqi, pra nuk ka shteruar efektet për të cilat është mbajtur, pasi nga aktet e administruara, nuk rezulton që pas heqjes dorë nga trashëgimi (veprim juridik i vlefshëm ky, të cilin K. Civil e kushtëzon me kohë), ky veprim të jetë regjistruar e më pas të jetë lëshuar një dëshmi e re trashëgimie, ku të pasqyrohej ndryshimi në rrethin e trashëgimtarëve, si dhe pjesët e tyre takuese. Në vlerësim të akteve të administruara, rezulton se fëmijët e subjektit të rivlerësimit, si trashëgimtar të thirrur me zëvendësim, në cilësinë e tyre si bashkëpronarë së bashku me dajën e tyre, kanë kryer disponime mbi pasuritë përkatëse dhe veprime juridike lidhur me to, të paktën deri në vitin 2018. Në këtë rast, duket jo bindëse që subjekti i rivlerësimit të mos ketë pasur asnjë dijeni të këtyre veprimeve dhe situatës së bashkëpronësisë reale për gati 9 vite, pra nga viti 2009, kur pretendon se ka hequr dorë nga trashëgimia në cilësinë e kujdestarit ligjor të fëmijëve të tij.

21.1 Mosdijenja e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në këtë rast nuk mund vlerësohet si përgjegjësi vetëm e shtetasit ***.***, pasi nuk ka ndërmarrë veprimet përkatëse pranë (ish) ZVRPP-Kukës. Referuar përcaktimeve të nenit 192 dhe 193, të K. Civil, që heqja dorë dhe kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtshme nga një pronar në tjetrin të jetë e vlefshme, duhet që ajo të bëhet nëpërmjet një veprimi noterial dhe të regjistrohet. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me ndonjë akt të vlefshëm kalimin e pronësisë nga fëmijët e tij të shtetasi ***.***. Për këtë arsye, për qëllime të procesit të rivlerësimit, konstatohet se personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit ende gëzonin të drejta reale mbi këto pasuri të paktën deri në 2018, rrjedhimisht, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur detyrimin për të deklaruar këto pasuri në deklaratën “Vetting”, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni.

21.2 Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se subjekti, si pjesë e familjes bujqësore ka përfituar tokë bujqësore bazuar në ligjin nr. 7501, pasuri të cilën

gjithashtu (për pjesën takuese) nuk e ka deklaruar as në deklaratimet periodike vjetore dhe as në atë “Vetting”.

21.3 Komisioneri Publik, duke përfunduar, vlerëson se nuk ka asnjë rrethanë ligjore të vlefshme që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, të mos deklaronin saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklaratimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklaratimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur, si dhe “burimin” në momentin e krijimit të saj. Ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkaku apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këtë drejtim deklarata e pasurisë “Vetting”, shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, është mjaft e qartë kur përcakton se “Objekti i deklaratimit”: “Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur etj.”. Bazuar në këtë situatë faktike të konstatuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit së bashku me personat e lidhur (fëmijët), ndodhen në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të pamjaftueshmërisht për kriterin e pasurisë, në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

IV. B Për vlerësimin e aftësive profesionale

22. Bazuar në përcaktimet e nenit E të aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale për subjektet që ushtrojnë funksionin e prokurorit, bazohet në aftësitë për të hetuar dhe për të ngritur akuzën publike, aftësia organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, si dhe cilësitë personale. Ndërsa për burimet dhe procedurën mbi të cilat kryhet ky vlerësim, neni 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të drejton në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa ky ligj gjen zbatim.

23. Komisioni, për vlerësimin e këtij kriteri, ka administruar dhe shqyrtuar 19 denoncime të publikut lidhur me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Pas verifikimit fillestar, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit për 9 prej tyre, përkatësisht për denoncimet e shtetasve ***.***, ***.***, ***.***, ***.***, ***.***, ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***. Nga vlerësimi i këtyre denoncimeve, kanë rezultuar disa mangësi, të tilla që për nga provueshmëria e tyre, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kanë kaluar si barrë prove subjektit të rivlerësimit, për të paraqitur prova dhe për të dhënë shpjegime për të kundërtën. Komisioni ka konstatuar për këto raste, këto gjetje:

(i) Evidentohen raste të prishjes së vendimeve të mosfillimit dhe/apo pushimit të procedimeve penale nga gjykata, duke u konstatuar prej saj mungesa e kryerjes së veprimeve hetimore dhe/apo duke u orientuar kryerja e veprimeve hetimore konkrete;

(ii) Evidentohen çështje në të cilat subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga gjykata në hetimin e tyre, arsye për të cilën, pas kërkesës së bërë prej tij për pushimin e çështjes, gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve;

(iii) Evidentohet një rast në të cilin subjekti ka vendosur regjistrimin e një procedimi për një vepër tjetër, ndryshe nga sa kishte urdhëruar gjykata;

(iv) Evidentohet material kallëzues i trajtuar nga subjekti, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal përtej afatit të përcaktuar në nenin 291 të K. Pr. Penale.

24. Komisioni, pasi ka marrë në shqyrtim prapësimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin, se për denoncimet e paraqitura nga publiku nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

25. Komisioneri Publik, mbështetur në rekomandimin për paraqitje ankimi të ONM-së, çmon se përfundimi i Komisionit është i mangët, i paarsyetuar dhe është rrjedhojë e një vlerësimi jo tërësor të fakteve dhe rrethanave të dala nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës. Nga vlerësimi i denoncimeve të paraqitura, në vëmendje të katër prej tyre (***.**, ***.**, ***.**, ***.**), konstatohen mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit lidhur me aspektin e njohurive dhe arsytimit ligjor, që konsistojnë në marrjen e vendimeve edhe veprimeve hetimore apo aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetime, mangësi këto që duhen vlerësuar sipas nënindikatorëve të nenit 73 dhe 74, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar. Këto mangësi duhen vlerësuar edhe në vështrim të një vlerësimi të përgjithshëm, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, do gjejnë trajtim në mënyrë të përmbledhur, faktet dhe rrethanat e rezultuara për katër prej çështjeve të sipërcituara, hetuar nga subjekti i rivlerësimit.

26. Procedimi penal nr. */2018, denoncimi i shtetasit ***,**.**

26.1 Komisioni, ka administruar aktet që i përkasin kallëzimit për procedimin penal nr. ***/2018, ndjekur nga subjekti i rivlerësimit. Nga aktet e administruara, rezulton se me vendimin e datës **.4.2018, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, të vitit 2018. Kjo vendimmarrje e subjektit të rivlerësimit është ankimuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, e cila me vendimin nr. *** Akti, datë **.6.2018, pasi e ka gjetur të gabuar arsyetimin ligjor të subjektit të rivlerësimit dhe shkakun e mosfillimit të procedimit, ka vendosur shfuqizimin e vendimit, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Mashtrim”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal.

26.2 Në vijim, subjekti i rivlerësimi, me urdhrin e datës **.7.2018, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. ***/2018 për veprën penale “Falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve”, parashikuar nga neni 190 i K. Penal. Me kërkesën e datës **.3.2019, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar gjyqtarit të hetimit paraprak, duke kërkuar pushimin e kësaj çështje penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** Regj., Them., datë **.5.2019, ka vendosur kthimin e akteve organit të Prokurorisë, pasi nuk ka zbatuar asnjë nga detyrat e lëna nga Gjykata me vendimin nr. ***/2018. Për kryerjen e këtyre veprimeve, Gjykata i ka

lënë subjektit të rivlerësimit tre muaj kohë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. ***, datë **.10.2019.

26.3 Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar sërish gjykatës me kërkesë për pushimin e çështjes penale me nr. ***/2018, dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me vendimin nr. *** Regj., Them., të datës **.10.2020, ka vendosur sërish kthimin e akteve organit të Prokurorisë, për shkak se prokurori, subjekti i rivlerësimit, nuk ka zbatuar asnjë nga detyrat e lëna nga gjykata me vendimin nr. ***/2018, duke urdhëruar edhe në këtë rast, regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të “Mashtimit”, parashikuar nga neni 143 i K. Penal. Për kryerjen e këtyre veprimeve, gjykata i ka lënë 3 muaj afat subjektit të rivlerësimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar.

26.4 Në datën **.12.2020, subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. ***/2018, dhe gjykata me vendimin nr. *** Regj. Them., datë **.2.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës, duke pushuar çështjen penale nr. ***/2021, që i përket procedimit penal nr. ***, datë **.7.2018, për veprën penale të “Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve” dhe “Mashtim”, parashikuar nga neni 190 dhe 143 i K. Penal.

27. Procedimi penal nr. */2017, denoncim i shtetasit ***,***.**

27.1 Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës **.7.2017, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. ***, të vitit 2017. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. *** Akti, datë **.2.2018. Me ankim të kallëzuesit/denoncuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.4.2018, pasi ka konstatuar se organi i Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë hetim në mbështetje të vendimit për mosfillim të procedimit, ka lënë si detyrë përmbushjen e disa veprimeve hetimore të domosdoshme, duke kthyer aktet për vijimin e hetimeve.

27.2 Nga aktet e administruara, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale me nr. *** Akti, datë **.8.2019, vendimmarrje kjo e lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë me vendimin nr. ***, datë **.11.2019. Me ankim të viktimës së veprës penale, denoncuesit ***,***, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë **.2.2020, pasi ka konstatuar sërish se hetimet e organit të akuzës ka qenë të paplota dhe nevojën e thellimit të tyre, ka vendosur ndryshmin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kthyer aktet prokurorit për vazhdimin e hetimeve për një afat prej 90 ditësh.

